



|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Primjeno/Prudato<br>Received/Delivery | 21-05-2021                    | viti<br>god<br>year           | 1                             |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jedinica<br>Org./Unit               | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKMBSTHC  | 2576/2021                     |                               | 119                           |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.301/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-** Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.301/2021 të datës 26.04.2021 e parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës-kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20/05/2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Shpallet jo kompetent** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.301/2021 e datës 26.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me Vendimin me numër të referencës 127/13 të datës 20.03.2013 të marrë nga Ministri i Punëve të Jashtme, emërohet "*Këshilltarë*" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Federatën e Belgjikës-Bruksel. Ndërsa me datë 29.10.2020 Presidenti i Republikës së Kosovës nxjerr Dekretin me numër 156/2020 me të cilin dekret ankuesit i miratohet grada diplomatike "*Ambasador*".

Ankuesi nëpërmjet e-mail-it zyrtar me datë 01.03.2021 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, për çështjen e pagës pasi që nuk paguhet sipas gradës diplomatike që e ka. Me datë 02.03.2021 Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore kërkon interpretim ligjor nga Udhëheqësi i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate. Me datë 05.03.2021 Udhëheqësi i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate kthen përgjigje lidhur me kërkesën e ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me mos realizimin e pagës sipas gradës diplomatike që posedon me datë 26.04.2021 parashtron ankesë nëpërmjet e-mailit zyrtar me numër të protokollit 1992/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.05.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës të cilën kërkesë Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës e ka pranuar me datë 07.05.2021. Më datë 12.05.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/16.

Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe për vendosje në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 26.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 29.10.2020; E-mail i datave 01.03.2021, 02.03.2021; 04.03.2021, 05.03.2021 dhe i datës 01.04.2021; Dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 23.09.2020; Vendimi i datës 20.03.2013 i Ministrisë të Punëve të Jashtme për emërim dhe caktim të gradës diplomatike; Nota Verbale e datës 13.10.2020; Kartela e nëpunësit nga muaji tetor i vitit 2020 deri më maj 2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, e posaçërisht përgjigjes në kërkesë nga organi i punësimit i datës 12.05.2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në të cilën përgjigje është theksuar se: *“z. **nuk posedon Akt emërim me Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sepse emërimi i tij ka qenë direkt në mision me vendim të ministrit**”*, kështu duke ia bashkangjitur edhe Vendimin me numër të referencës 127/13 të datës 20.03.2013 të Ministrisë të Punëve të Jashtme, andaj Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk e ka statusin e shërbyesit civil sipas nenit 3 paragrafit 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi”*, më tej Kolegji ka konstatuar se po ashtu edhe sipas dispozitave ligjore të nenit 4 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në bazë të këtij ligji, statusin e nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme:... të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet më Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale”*, andaj Kolegji konstaton se, rrjedhimisht nuk qëndron pretendimi i ankuesit i cili në ankesën e datës 26.04.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pretenduar se në Ministrinë e Punëve të Jashtme është rekrutuar përmes konkursit publik dhe është diplomat i karrierës që nga viti 2013.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me mos marrjen e pagës në pajtim me gradën e tij diplomatike të fituar sipas Dekretit me numër 156/2020 të datës 29.10.2020 të marrë nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankese, pasi që ankuesi nuk ka status të nëpunësit civil në bazë të nenit 3 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: Ky ligj nuk zbatohet për: *“2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura”*, sepse në rastin konkret krijimi i marrëdhënies së punës së ankuesit është bërë në bazë të emërimit të datës 29.10.2020 sipas Dekretit me numër 156/2020 nga Presidenti i Republikës së Kosovës ashtu siç parashihet edhe me nenin 7 paragrafin 7.1, 7.8 dhe 7.10 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ku thuhet se: *“7.1. Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret”, “7.8. Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarët në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm” dhe “7.10. Emërimi i Konsujve të Përgjithshëm bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës”.*

Bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, pranimi në shërbim të jashtëm bëhet nëpërmjet konkursit të hapur si dhe në pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe Shërbimin Diplomatik si dhe legjislacionin në fuqi. Ndërlidhur me këtë neni 8 i Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ka përcaktuar se: *“Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarave politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës.”*

Andaj bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se Këshilli nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit sepse në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi nuk është pranuar në shërbimin e jashtëm nëpërmjet konkursit të hapur dhe nuk ka nënshkruar akt emërim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjithave shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.301/2021, datë 20/05/2021

Valentina Kacandolli BEKTESHI

*Valentina Kacandolli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesi,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe të Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës së Jashtme dhe të Diasporës dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së

